



LGBT e-NEWS

Numri 1, Viti I i Botimit, Gusht 2010, TIRANË

Financuar nga: Programi MATRA, Ministria e Punëve të Jashtme e Hollandës
Botim i LGBT PRO Shqipwri në partneritet me COC Hollandë

Të hështësh = të pranosh diskriminimin

Shqipëria raporton para OKB për të drejtat e grave dhe vajzave të cilat, sipas Koalicionit të Raportimeve Alternative (ACPAR) rezultojnë se janë më të rrezikuara nga dhuna brenda në shtëpi. Falë kontributit të LGBT PRO Albania dhe Aleancës Kundër Diskriminimit në këtë raport u përfshi për herë të parë raportimi për të drejtat e femrave lezbike, biseksuale dhe transgjimore.

Shqipëria prezantoi në korrik, gjatë sesionit të 46 të CEDAW (Konventa për Eliminimin e cdo forme të Diskriminimit të Grave) raportin hije të shoërisë civile, ku për herë të parë u paraqit situata që jetojnë gratë e vajzat lezbike, biseksuale dhe transgjimore. Znj. Meri Poni paraqiti pranë OKB këtë raport hije, në emër të Koalicionit Shqiptar për Raportimet Alternative. Gjatë një deklarate të lexuar para komitetit të

CEDAW, në lidhje me komunitetin e grave dhe vajzave lezbike, biseksuale dhe transgjimore, Poni vuri në dukje se ato jetojnë mes një mjedisi ekstremisht homofob dhe përjetojnë diskrimin e intolerancë të hapur, ndërkohë që qeveria nuk ka marrë asnjë hap konkret për të krijuar mekanizma funksionalë për ti dhënë fund diskriminimit apo për tu krijuar këtyre grave dhe vajzave mundësinë për të adresuar nevojat, shqetësimet dhe kërkesat e tyre. Në paragrafin e lexuar nga znj. Poni para Komitetit të CEDAW në lidhje me komunitetin LBT vihej në dukje gjithashtu se ky komunitet i grave është i privuar edhe nga mbrojtja e policisë dhe shpesh janë dokumentuar raste kur u është mohuar edhe shërbimi shëndetësor. Shoqëria civile rekomandoi para OKB se shteti shqiptar duhet të ndërmarrë politika të posacme për të përmirësuar jetën e komunitetit LBT ndërkohë

që duhet menduar edhe si çështje të tilla të bëjnë pjesë sa më parë në kurrikulat mësimore në mënyrë që të promovohet respekti ndaj LBT që në bankat e shkollës. Në raportin hije të ACPAR në kuadër të Konventës për Eliminimin e cdo forme të Diskriminimit ndaj Grave vihej në dukje gjithashtu niveli i ulët i pjesëmarrjes së tyre në politikë si dhe dhuna e patolerueshme që gratë e vajzat shqiptare përjetojnë brenda shtëpive dhe familjeve të tyre. Një situatë ekstremisht të vështirë përjetojnë gratë e komunitetit rom dhe egjiptiaan si dhe ato që janë në konflikt me ligjin. Tashmë ka ardhur koha që gratë dhe vajzat shqiptare, pavarësisht orientimit të tyre seksual të marrin në dorë fatin e tyre, të ndërgjegjësohen për të drejtat e tyre dhe të ngrejnë zërin. Sepse të heshtësh, është njësoj si të pranosh dhunën dhe diskriminimin...

LBT shqiptare, për herë të parë në OKB

LBT nuk mund t'u tregojnë orientimin e tyre seksual edhe pjesëtarëve të familjes. Duke heshtur mendojnë se mbrojnë veten dhe familjen.

Nëse e deklarojnë orientimin seksual rrezikojnë të përballen me dhunë fizike në rrugë, familje, shkolla e kudo.

Përjetojnë presion të madh nga familjarët që të martohen ose fejohen sa më parë.

LBT të cilat vishen e sillen dukshëm si të tilla e kanë të pamundur të punësohen e të përfitojnë shërbime publike.

“Gropa , Jeta dhe Vdekja jonë...”

Rrëfimi tronditës i transgjnorëve në Shqipëri: Na dhunojnë klientët, homofobët por edhe policia. Nuk duam të prostitujmë por nuk kemi asnjë mundësi tjetër për të mbijetuar...



Nikoleta, 49 vjeç është e para pjesëtare e komunitetit transgjnor e cila doli në televizor dhe u tha të gjithë njerëzve se kishte vendosur të jetonte si femër e jo si burrë me emrin Nazmi Toska (emër që ajo vazhdon ta mbajë në dokumentat zyrtare). Pasi shokoi të gjithë opinionin publik Nikoleta iu desh që nga ajo ditë të hynte në një kalvar të pambarimtë peripecish në jetën e saj. Baba i dy fëmijëve të rritur, frut i martesës së saj të imponuar në qytetin e Elbasanit, Nikoleta është sot e pastrehë, e papunë, e detyruar të prostitujë në një moshë që nuk e favorizon fare atë në këtë profesion. Tashmë ajo është në mëshirën e fatit apo të klientëve të saj, të cilët jo pak herë e kërcënojnë se do ta vrasin. “Jetoj në një kasolle prej kartoni në një lagje të komunitetit rom”, i tha Nikoleta pjesëtarëve të PINK Embassy, “kur nuk kam të holla as për të blerë bukë, u kërkoi borxh 200 lekë të reja romëve në lagjen time dhe më vonë u duhet t’ua kthej në formën e kamatës: nëse më japin borxh 200 lekë, unë atyre duhet tu kthej mbrapsht 500 lekë”. Ashtu si për Nikoletën, jeta është

“Gropa është edhe jeta jonë, pasi atje ne mund të sigurojmë bukën e gojës, por është edhe vdekja jonë, pasi atje ne rrezikojmë të vritemi çdo ditë”

ekstremisht e vështirë për të gjithë pjesëtarët e tjera të këtij komuniteti në Tiranë. Anxhela është gjithashtu e njohur në publik për shkak të protagonizmit të saj edhe në media.

e ngacmojnë, e dhunojnë dhe e diskriminojnë. Disa javë më parë një klient i saj e sulmoi duke i lënë plagë të shumta në trup. Në spital, ajo rrëfen se dy mjekët të cilët duhet ta kuronin nisën të talleshin me të dhe ta keqtrajtonin psikologjikisht. PINK Embassy dhe LGBT PRO Shqipëri ka zhvilluar një sërë takimesh me komunitetin e transgjnorëve. Gjatë këtyre takimeve vetë transgjnorët kanë treguar për të gjitha vështirësitë me të cilat u duhet të jetojnë ditë pas

Por ashtu si dhe gjithë pjesëtarët e tjera të këtij komuniteti edhe Anxhelën e përbuzin, e tallin ngado ku shkon,

dite. Liderja e grupit Nikoleta flet në emër të të gjithave dhe tregon se komuniteti transgender është një komunitet i vogël i përbërë nga 10 persona në Tiranë, 4 në Durrës si edhe 2-3 përfaqësues të tjera në disa nga qytetet kryesore të Shqipërisë. “Problemet tona? dhuna psikologjike dhe fizike në mënyrë sistematike e ushtruar nga klientët, personat homofobë, por edhe nga policia” pohon Anxhela. Ato raportojnë një numër të madh rastesh dhune të ushtruara ndaj tyre. Rasti më i fundit ishte ndaj njëres prej përfaqësuesve të komunitetit e quajtur Klea, e cila rreth datës 15 Qershor, kishte pësuar dhunë fizike dhe ishte kërcënuar me thikë nga një prej klientëve të saj, pranë vendit ku ato punojnë (“gropa” pas Bibliotekës Kombëtare). Shoqet e saj kanë lajmëruar policinë e cila ka mbërritur në vendngjarje dhe ka kapur dhunuesin.



→ Por ato pohojnë se dhunuesi është liruar nga policia pas pak minutash, pasi po ky person ka shkuar përsëri pranë vendit të punës së tyre dhe sërish i ka kërcënuar. Gjithashtu përfaqësueset e komunitetit pohojnë se policia ka ushtruar dhunë mbi to po atë ditë kur ka shkuar për të kapur dhunuesin. Veç kësaj, ato e kanë të pamundur të ulen si njerëz të zakonshëm në një bar e të pijnë një kafe pasi menjëherë kamarierët do t'i dëbojnë.



punëson. Ajo i kërkoi PINK Embassy që ta ndihmojë në mënyrë që të paktën të përfitojë nga asistenca sociale si e papunë. Por duke qenë se Nikoleta figuron banore e Elbasanit, ajo e ka të pamundur që të përfitojë asistencën sociale. Duhej për këtë, transferimi në gjendjen civile të Tiranës por kjo nuk mund të bëhej përsa kohë që Nikoleta nuk ka një kontratë qëraje në Tiranë. “Askush nuk na jep me qera një banesë”, rrëfen Nikoleta, “për më tepër që ne e kemi të pamundur që ta paguajmë për shkak të varfërisë”.

Kësisoj, i gjithë sistemi shtetëror në rastin e transgjitorëve rezultojnë të jetë një rreth vicioz që nuk zgjidh dot asnjë hall të tyre e kësaj është i dështuar. “Gropa është edhe jeta jonë, pasi atje ne mund të sigurojmë bukën e gojës, por është edhe vdekja jonë, pasi atje ne rrezikojmë të vritemi çdo ditë”, pohojnë ato.

PINK Embassy dhe LGBT PRO Shqipëri konstatoi se asnjëra prej tyre nuk dëshiron të ushtrojë prostitucion, por ajo është e vetmja zgjidhje që ato kanë për të mbijetuar dhe për t'i bërë ballë varfërisë ekstreme. Nikoleta kërkon të punësohet por askush nuk e

“Ndihem i internuar në vendin tim”

LETËR E HAPUR

Drejtuar: Z. Sali Berisha
Kryeministër i Shqipërisë dhe Kryetar i Partisë Demokratike
Z. Edi Rama
Kryetar i Partisë Socialiste dhe Kryetar i Bashkisë Tiranë
I nderuar zoti Kryeministër,
I nderuar zoti Kryetar i Opozitës,

Po ju drejtohem me këtë letër të hapur për të ndarë me ju shqetësime që nuk janë vetëm të miat personalisht, por besoj edhe të atyre njerëzve të cilët kanë një orientim seksual të ndryshëm nga të tjerët. Por fillimisht dua t'ju falenderoj publikisht për disa nga kontributet tuaja në lidhje me të drejtat e njeriut në Shqipëri:

Z. Kryeministër! Më lejoni t'ju falenderoj që si

sot një vit më parë ju guxuat të flisnit publikisht për të drejtat e komunitetit



LGBT (lezbike, gej, biseksualë dhe transgjitorë). Kontributi juaj publik ka qenë një shtysë për t'i dhënë fund diskriminimit në Shqipëri, shoqëria jonë po përgatitet të hyjë në rrugën e pakthyeshme të emancipimit. Si Kryetar i

Në këtë situatë në të cilën unë dhe familja ime ndodhemi sot mund të ndodhen edhe familjet e qindra mijëra të rinjve dhe të rejave në të gjithë Shqipërinë.

maxhorancës, më lejoni t'ju falenderoj që në Shkurt të këtij viti ju personalisht dhe maxhoranca që ju drejtoni morët përsipër të aprovonit për herë të parë në Shqipëri një

ligj ambicioz kundër diskriminimit. Z. Kryetar i opozitës! Jam në dijeni të përpjekjeve tuaja të dikurshme, por edhe aktuale për të emancipuar

Sot jam HOMOSEKSUAL

Nga Kristi Pinderi



Ka shumë arsye pse Klodi i Big Brother acarontë shumicën e shqiptarëve sot! Klodi acarontë intelektualët, acarontë politikanët, ai acarontë gazetarët e drejtuesit e medias! Klodian çela acarontë në njëfarë mënyre vetë komunitetin e homoseksualëve dhe të lesbikeve, madje madje, Klodi acarontë edhe komunitetin e transgjitorëve në Shqipëri! Me atë që ka bërë, apo që nuk ka mundur të bëjë, Klodi i turbullon të gjithë sot në Shqipëri. Pikësëpari intelektualët! Ndiqini me vëmendje intelektualët e angazhuar publikisht, kur prononcohen për Klodin! Ata nuk flasin pothuajse asnjëherë për homoseksualizmin, as për lesbizmin, as për personat biseksualë.



Rasti i Klodit shqetëson me shumë të drejtë të gjithë shoqërinë shqiptare! Mbi të gjitha shqetëson ato dhjetëra, qindra e ndoshta mijëra nëna, që sot vuajnë në vetmi



Nuk artikulojnë pothuajse asnjëherë në media rëndësinë e respektimit të të drejtave të komunitetit LGBT, njësoj si të drejtat e çdo njeriu tjetër! Intelektualët tanë, kur vendosin të prononcohen për "Klodin", preferojnë të analizojnë e të filozofojnë jo për të drejtën e Klodit për të qenë ai që është, por bëjnë si bëjnë dhe flasin për median... për rolin sipas tyre "të ekzagjeruar" për të treguar një padrejtësi (në



opinionin e përgjithshëm në lidhje me rastin e Klodian çelës, media ka luajtur rolin e 'fryrjes' së një fenomeni), flasin për familjen..., për shoqërinë...! Tek tuk shkruajnë rreshta empatikë për të treguar se nuk janë homofobë! Në fund "bërtasin", jo për Klodin, apo të tjerë si Klodi, po për faktin që media (ky Gogol i pakontrollueshëm) po na e "keqpërdorkërka" të drejtën e kujtdo për t'u shfaqur atje/këtu ashtu si është, e madje për t'u ndërre krenar për atë që është. E si "garniturë", shtojnë edhe fjalinë: pse na imponohet media?! Shqiptarët nuk janë homofobë...PD, PS dhe gjithë politika shqiptare dështon!

Një pjesë tjetër e shoqërisë, që nuk dëshiron, e në fakt nuk mund të përballet dot me "Klodin", janë politikanët shqiptarë! Këta të fundit, referencat homofobike, i kanë përdorur kudo e kurdo që kanë mundur! Kryeministri me një origjinë dhe mënyrë jetese konservatore, e përdori homofobinë për të fituar e jo për të humbur kredo politike, kur një vit më parë, në vend që t'u fliste shqiptarëve për zgjedhjet e 28 qershorit, u hodhi si "rrufe në ditë me diell" idenë e martesave mes së njëjtës gjini!

Sot, Kryeministri beson se është përballur njëherë me "Klodin"! Se punën e vet e ka bërë njëherë! Se një kontribut e ka dhënë ndërkohë...

Po sikur Kryeministri të përballet tani me këdo "Klod", publikisht, që i thotë: "zoti Kryeministër, dua të martohem me të dashurin tim, a mund të më mbështetësh publikisht?" çfarë do duhet t'i thoshte "Klodit" z. Berisha...?

Ndaj nuk do të përballet me asnjë "Klod", Kryeministri shqiptar...

Partia Socialiste, ashtu si dhe gjithë e majta shqiptare, kanë dështuar për ta shndërruar çështjen e respektimit të të drejtave të njeriut si një çështje parësore të programit të tyre, ndonëse në mes të deputetëve më dinjitozë të kësaj partie rreshtohen sot figura ndërkombëtarisht të njohura në fushën e aktivizimit për të drejtat e njeriut në Shqipëri! 1/3, në mos më shumë, e atyre që sot bëjnë politikë në Partinë Socialiste, dje kanë milituar për të drejtat e njeriut, e sipas Principeve të Xhakartës (2006) që Shqipëria i ka nënshkruar si "soft laws", të drejtat e LGBT janë mbi të gjitha edhe të drejta të njeriut!

Në mitingjet dhe protestat e opozitës, krijohet gjithnjë e më shumë hapësirë për fjalime që motivojnë e frymëzojnë homofobinë! Madje në fjalimet e aleatëve të PS paralelizohet koalicioni LSI-PD, si një "martesë" mes së njëjtës gjini, kryetarët e liderët e partive të majta lejohen e frymëzohen që në fjalimet e tyre drejtuar turmës ta venë medomosdo këtë paralelizëm banal mu në mes të fjalimeve të tyre!

Klodi, rasti i tij personal dhe kurajoja për të treguar të vërtetën, i bën politikanët e ligjëvënësit shqiptarë të ndihen në siklet që Shqipëria nuk ka ende një legjislacion kundër krimeve apo incidenteve të motivuara për shkak të urrejtjes, homofobisë, apo transfobisë!

E thënë troç: të drejtat e njeriut, nuk kanë qenë asnjëherë prioritet, as i maxhorancës aktuale, as i opozitës!

Kanë 20 vjet mitorët e shkretë që vdesin e

lenë në honin e minierës e të "prostitucionit" politik, të gjitha shpresat, aspiratat dhe ëndrrat për një jetë më dinjitoze...

Po pse, mos me "lëvizjen për të drejtat e grave" është bërë ndonjë punë më e mirë?! Të pasurit disa deputetë më shumë në Kuvend, mos ndoshta tregojnë se ia paskemi dalë të mbrojmë të drejtat e tyre mijëra grave të nëpërkëmbura mu në mes të jetëve tona...?! A mos kemi mundur ne, si shoqëri të bëjmë ndonjë gjë të hajrit për ata njerëz, ata njerëzit ndoshta më të dashur për ne të cilët, nuk shohin, nuk mund të ecin, nuk mund të dëgjojnë, nuk mund të jetojnë drejt e mori edhe fatkeqësinë e tyre...?!!!!!

Rasti personal i Klodit shqetëson me shumë të drejtë të gjithë shoqërinë shqiptare! Mbi të gjitha shqetëson ato dhjetëra, qindra e ndoshta mijëra nëna, që sot vuajnë në vetmi nga mungesa e informacionit, që sot, ndoshta "urrejnë" Klodin që guxoi t'u tregojë në sy të të gjithë botës që ... drejt e mori: DISA NJJEREZ JANE GAY DHE PIKE! Kështu ka qenë, kështu është, e kështu do të jetë... Shoqëria ndryshon shumë ngadalë, e ndryshon hap pas hapi.

Politika, ndryshon e fundit...

Ajo që duhet të ndryshojë e para, janë këta të "uruarit" intelektualë që ne mezi i presim të na ndriçojnë sa herë media u jep mundësi të flasin pa frikë e komplekse për të vërtetën! Unë sot ndjej nga zemra të falënderoj z.

Lubonja dhe këdo tjetër që mundi ta kuptojë se të drejtat e njeriut, janë (apo më së paku do duhet të jenë) mbi të gjitha edhe një lëvizje politike dhe me plot gojë them: SOT UNE JAM HOMOSEKSUAL!

Vazhdimi i letrës së Klodit: "Ndihehem i internuar në vendin tim"

shoqërinë shqiptare. E kam ndjekur me vëmendje aktivitetin tuaj të mëparshëm publicistik dhe shumë shpesh jam frymëzuar nga kurajoja që ju ka karakterizuar për të shkruar në shtyp për të drejtat e njeriut e për të kërkuar mbrojtjen e barabartë të tyre. Më lejoni t'ju falënderoj për këtë.

Zotërinj,

Sot ndihem i mbështetur në të drejtën time për të jetuar i barabartë mes të barabartëve dhe i respektuar nga mesazhi i datës 22 qershor kur Sekretarja e Departamentit të Shtetit znj. Hillary Clinton më inkurajoi personalisht për hapin që kisha ndërmarrë, ashtu sikurse komuniteti ndërkombëtar dhe një pjesë e mirë e shoqërisë civile në Shqipëri. Megjithatë nuk mund të mos përcjell publikisht realitetin me të cilin unë dhe familja ime, njerëzit e mi më të dashur, që nga dita kur unë kam dalë nga Big Brother, po përballemi me një realitet të cilin dëshiroj ta ndaj me ju, pasi unë besoj se politikanët e vendit tim duhet të shërbejnë si model për të gjithë shoqërinë. Prej 45 ditësh unë ndodhem jashtë shtetësisë së "Big Brother". Që prej 45 ditësh, unë, familjarët e mi dhe njerëzit e mi më të afërm, po përballemi me një realitet tepër të vështirë. Familjarët e mi sot po vuajnë për bukën e gojës. Të drejtat e tyre po shkelen ditë pas dite nga fryma e urrejtjes dhe diskriminimit, për shkak të orientimit tim seksual. Nuk e doja veten ditën kur pashë Policinë e Durrësit të ushtronin dhunë psikologjike ndaj nënës sime duke i kërkuar me prepotencën që ta jep uniforma të largonte një tezgë të vogël shitjeje me të cilën siguron bukën e gojës. Unë nuk kërkoj të shkelet ligji, por dua që njerëzit të kuptojnë se ajo tezgë është e vetmja mënyrë të ardhurash për familjen time që punon për të mbijetuar, jo për të

jetuar, e që tashmë nuk guxon as të ketë një jetë sociale nga frika se njerëzit do t'i tregojnë me gisht. Që ditën e parë kur unë dola nga Big Brother nisa të kërkoj një vend pune, por ajo që po gjej, në vend të punës, është vetëm urrejtje, homofobi dhe bezdisje e pakuptimtë.

Në vitin 2010 unë ndihem i internuar në vendin tim.

Në këtë situatë në të cilën unë dhe familja ime ndodhemi sot mund të ndodhen edhe familjet e qindra mijëra të rinjve dhe të reja në të gjithë Shqipërinë. Cdo shoqëri e hapur dhe demokratike ka për detyrë që ti ofrojë të gjithë anëtarëve të saj mundësi të barabarta për të jetuar të respektuar dhe me dinjitet. Unë besoj se është detyra juaj si politikanë që të promovoni këto vlera në shoqërinë shqiptare. Cdo individ lind i lirë dhe i barabartë në të drejtat dhe dinjitetin e tij.

I nderuar z. Kryeministër, I nderuar Kryetar i opozitës,

Unë vendosa të qëndroj në Shqipëri, ndryshe nga shumë vetë që kishin besuar se do t'ia mbanja nga sytë këmbët, vetëm sepse kisha guxuar të theyeja një tabu. Unë vendosa të qëndroj në këtë vend t'u përballur me dinjitet me të gjitha sfidat që ka shoqëria shqiptare. Unë pres që mesazhet e mbështetjes të mos më vinë mua apo kujtdo tjetër që është pjesë e komunitetit LGBT, vetëm nga ndërkombëtarët. Unë pres që politikanë si ju të tregojnë publikisht se mirëqenia sociale, fizike, e shpirtërore e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, pa dallim, është realisht e mundshme.

Tani është koha për fjalën tuaj dhe më shumë se kaq për veprimin tuaj.

Sinqerisht,
Klodian Çela

Pink Embassy dokumenton fjalimet që ushqejnë urrejtje

Gjatë muajit korrik disa politikanë shqiptarë u përfshinë në një seri akuzash të ndërsjellta, të cilat për nga përmbajtja dhe mënyra se si u shfaqën përbënin raste të pastra të fjalimeve që ushqejnë urrejtje “hate speeches”. Në 15 korrik, z. Dritan Prifti një ministër i qeverisë, i akuzuar nga opozita se ishte pasuruar me 1.8 milion euro gjatë vitit të fundit përmes metodave korruptive u përgjigj në Parlament me një ton agresiv. Një ditë më pas ai e akuzoi kryetarin e opozitës, z. Edi Rama

Gjuha e tillë frymëzon urrejtjen dhe motivon direkt ose indirekt diskriminim

duke thënë: “Nuk është faji im që ai njeri (Rama) është një pervers seksual dhe ka orientime qesharake seksuale”. Gjuha e tillë frymëzon urrejtjen dhe motivon direkt ose indirekt

diskriminim, urrejtje, izolim e marxhinalizim të mëtejshëm të kujt do personi që mund të ketë një orientim të ndryshëm seksual nga ai i shumicës. Menaxherja e programit Pink Embassy, znj. Etleva

Bisha reagoi duke botuar në 20 korrik një editorial të botuar në të përditshmen Shqip.

RASTI PRIFTI DHE POLITIKA “BËJMË SIKUR”

Nga: Etleva Bisha
(Botuar në gazetën Shqip)

Politikanët tanë kanë dështuar më shumë se një herë në përmbyshjen e tyre funksioneve që ata i mbajnë për shkak të angazhimit të tyre politik. Kanë dështuar sa herë kanë shkuar te zgjedhësit në fushata elektorale e u kanë premtuar ndryshime edhe deri te detaji i jetës së tyre, por kur kanë marrë pushtetin, kanë harruar se çfarë kanë premtuar. Kanë dështuar në detyrën e tyre për të prodhuar politika që në thelb mbajnë në konsideratë interesat e shtetasve e për të dhënë më të mirën për shqiptarët, por mbi të gjitha kanë dështuar në atë që pas 20 vitesh sistem demokratik duhet t’u kishin garantuar shqiptarëve një sistem demokratik të zbatuar në praktikë. Rëndom në literaturën që trajton elementet e demokracisë në sistemet politike ndesh tipare të demokracisë: zgjedhje të përgjithshme të lira, liri e organizimit, liria e fjalës dhe e shtypit, liria e opinionit, barazi përpara ligjit... Po t’i marrësh një për një këto elemente gjen aq fakte që vërtetojnë se në secilin prej këtyre komponentëve përbërës së një sistemi demokratik në masën dërmuese në Shqipëri është bërë “sikur”. Ka 20 vjet që në Shqipëri bëhet “sikur”

realizohen zgjedhje të përgjithshme të lira, ku sovranit vendos me votë dhe jo pushteti prodhohet nga fitorja në tavolinë. Ligji garanton lirinë e fjalës dhe të shtypit, por më thoni, janë të pakta rastet kur liria e fjalës dhe e shtypit është dhunuar, sepse



Ministri Dritan Prifti

nuk i ka shkuar për shtat pushtetarit të radhës? Për të mos folur për barazinë përpara ligjit, kur zbatuesi i ligjit dënon për korrupsion “peshkun e vogël” dhe rreh gjoksin se e dënoi, por pa dënuar “peshkun e madh” atë që vazhdon të majmet, sepse në dorë ka pushtetin, pushtetin që e ka fituar në tavolinë dhe që e ka të sigurt se do të vazhdojë ta ketë për sa kohë që në Shqipëri bëjmë sikur kryejmë zgjedhje të lira.

SOME PEOPLE ARE GAY. GET OVER IT!



Stonewall përkujtohet në Tiranë

Aleanca dhe LGBT PRO bisedojnë për organizim te aktiviteteve të përbashkëta

Aleanca Kundër Diskriminimit përkujtoi ngjarjet e Stonewall në Tiranë duke organizuar një koncert ku morën pjesë anëtarë të komunitetit LGBT në Shqipëri si dhe persona heteroseksualë miqësorë ndaj tyre. Stafi i Pink Embassy mori gjithashtu pjesë në këtë koncert.

Pas këtij aktiviteti përfaqësues të LGBT PRO dhe Pink Embassy zhvilluan një takim me drejtues të Aleancës Kundër Diskriminimit. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit ranë dakort në domosdoshmërinë e bashkëpunimit mes dy organizatave: Aleancës dhe LGBT PRO. Përveç kësaj, PINK Embassy ftoi drejtuesit e Aleancës që të bëjnë pjesë në strukturën këshillimore dhe koordinuese që do të quhet “Miqte e Pink Embassy”.

Po dështimi i politikës për t'u dhënë shqiptarëve demokracinë reale të zbatuar në praktikë shkon edhe më tej. Politika në Shqipëri kryen edhe një funksion tjetër (aspak normal): atë të krijimit të modelit të gabuar, të edukimit negativ të publikut. Nuk besoj se ka nevojë t'u sjell fakte nga modeli i urrejtjes ndaj kundërshtarit që konsumohet çdo ditë në seancat parlamentare nga ata që janë elita e politikës shqiptare. E imagjinoni se çfarë efekti krijon te një dëgjues i edicioneve të lajmeve që pret të dëgjojë nga goja e politikës se çfarë do të ndryshojë në jetën e tij nga vendimet që përditë politika merr e në vend të vendimeve dëgjon se si shahen me fjalor rrugësh ata që janë elita e politikës? Pëshirosje, për atë pjesë dëgjuesish që pret një produkt nga politika (e që zor se e merr) dhe urrejtje për kundërshtarin, për ata dëgjues që janë "tifoze" partish. Gjuha e urrejtjes është bërë tashmë praktikë e zakonshme në punimet e Kuvendit të Shqipërisë dhe modeli që i ofrohet publikut është i gabuar. Por politika shqiptare bën "sikur" jo vetëm për atë që prodhon për shqiptarët, por edhe në marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare. Kam

përshtypjen që nëse bëhet një studim se cilat shtete kanë ratifikuar numrin më të madh të konventave ndërkombëtare, pavarësisht llojit dhe përmbajtjes së tyre, Shqipëria zë vendin e parë, sikurse zë vendin e parë edhe për mosnjohjen dhe mosrespektimin e tyre nga vetë elita politike. Qeveria shqiptare firmos konventa ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por ministrat e saj nuk i respektojnë këto të drejta, qeveria shqiptare firmos parimet e Xhakartës, miraton edhe një ligj antidiskriminim në Parlament, por mendoni se deputetët që e votuan atë (midis tyre edhe ministri Prifti) e njohin atë ligj? Jo, nuk e njohin, sepse po ta dinin se për çfarë përmbajtje ligji kanë votuar do të mendoheshin dy herë kur do t'i servirnin publikut shqiptar si ushqim të ditës modelin e gabuar dhe mesazhin e gabuar. Por ndodh kështu, sepse politika shqiptare bën sikur, por asgjë që bën nuk e ka të vërtetë.

Ajo që unë kuptoj nga e gjithë kjo histori sikuresh të klasës aktuale politike shqiptare është se kemi një tufë politikanësh që kanë hyrë në politikë pa kuptuar ABC-në e saj, që dinë se çdo të thotë sistem politik i demokracisë liberale (dhe të kuptosh është hapi i parë për të vijuar me zbatimin) më pak

se sa di një nxënës gjimnazi. Ata që sot janë ministra njohin vetëm anën e pushtetit me të cilën i vesh "mandati", por nuk njohin anën e detyrimit që kanë përpara çdo shtetasi të këtij vendi që akoma nuk ka gjetur kuptimin e politikës në këtë shtet. Akoma më keq: gjuha e urrejtjes që e prodhon një ministër në Parlament përhapet lehtësisht te publiku dhe ajo që unë kuptova si dëgjues i thjeshtë nga ministri Prifti pak ditë më parë (dhe për fat të keq edhe nga politikanë të tjerë në të njëjtën sallë) është e thjeshtë: kundërshtari im politik është armiku im! Armiku im ka gjithë të zezat e kësaj bote. Vetëm një gjë nuk kuptova nga fjala e zotit Prifti (si rasti më i fundit, por edhe nga politikanë të tjerë më parë): Përse të jesh homoseksual është perversitet? Zoti Prifti vetë ka ngritur kartonin për ligjin antidiskriminim, qeveria e tij ka firmosur parimet e Xhakartës? Dhe tani nuk po kuptoj për çfarë "bën sikur" zoti Prifti: "sikur" kur ka rënë dakord për ligjin, apo "sikur" kur thotë se të jesh homoseksual është perversitet?

Dhe në fund të fundit, ka shanse që një ditë politika shqiptare të mos bëjë më "sikur"????

NUK JEMI ATA QE DUKEMI...

Diskriminim ka edhe brenda komunitetit LGBT. Pjesëtarë të këtij komuniteti bisedojnë së bashku për këtë çështje

Në kuadër të planifikimit strategjik, Pink Embassy zhvilloi një takim me pjesëtarë të komunitetit LGBT në Shqipëri dhe i pyeti ata se çfarë mendojnë se ky program mund dhe duhet të bëjë për të adresuar të gjitha shqetësimet e këtij komuniteti.

Pas këtij takimi, vetë pjesëtarët e komunitetit kërkuar që të zhvillojnë edhe dy takime të tjera, si dhe një

trainim për procesin coming out, trainim që u ofrua vullnetarisht nga znj. Enila Cenko, PhD në Psikologji. Ndërsa gjatë takimit të tretë pjesëtarët e komunitetit LGBT folën rreth diskriminimit Brenda vetë komunitetit. Moderatorja e këtij takimi, znj, Belioza Coku, e cila është edhe ambasadore e Pink Embassy, i ftoi të pranishmit që të vizatonin në njëerën anë të një cope letre të bardhë mënyrën sesi njerëzit i shikojnë personat LGBT dhe mënyrën se si këta persona sillen me njerëzit. Ndërsa në anën tjetër të letres, Coku i ftoi ata të vizatonin veten e tyre ashtu siç në të vërtetë janë. Një prej pjesëtarëve të komunitetit LGBT e vizatoi veten (shikoni figurën) si një person të ngjashëm me një mace, një mace që të gric kur vjen puna në marrëdhënie me të tjerët dhe si një person të butë, të qeshur e të paqte për



të simbolizuar veten në të vërtetë. Coku i ftoi më tej ata që të bisedonin në këtë kuadër në lidhje me vetë diskriminimin që pjesëtarët e komunitetit LGBT i bëjnë njëri tjetrit apo njëra tjetrës. "Ka shumë njerëz që kërkojnë të ndihmojnë dhe të aktivizohen në kauzën LGBT", tha Coku, por mbi të gjitha duhet të jetë vetë komuniteti që t'i japë fund diskriminimit Brenda vetes dhe së bashku të luftojë për të drejtat e LGBT.